



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 18 datë 25.09.2025

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PROJEKTIT GJATË NDËRTIMIT PËR
OBJEKTIN: “GODINË BANIMI DHE SHËRBIMI ME 1, 6, 7, 8 DHE 10 KATE MBI
TOKË, ME 1 KAT PARKIM NËNTOKË, DHE “GODINË BANIMI DHE SHËRBIMI
ME PARKIM 1,6,7 DHE 8 KATE MBI TOKË, ME 1 KAT PARKIM NËNTOKË”,
ZONA 02, ZONA E MENAXHIMIT A02 DHE A04, ME VENDNDODHJE NË
“MARINA & JAHTET E DURRËSIT”, BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregulloreve të zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Durrës Marina” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të projektit gjatë ndërtimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi me 1, 6, 7, 8 dhe 10 kate mbi tokë, me 1 kat parkim nëntokë, dhe “Godinë banimi dhe shërbimi me parkim 1,6,7 dhe 8 kate mbi tokë, me 1 kat parkim nëntokë”, Zona 02, Zona e Menaxhimit A02 dhe A04, me vendndodhje në “Marina & Jahtet e Durrësit”, Bashkia Durrës.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur Vendimit Nr. 34, datë 01.08.2023 të Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi me 1, 6, 7, 8 dhe 10 kate mbitokë, me 1 kat parkim nëntokë” dhe “Godinë banimi dhe shërbimi 1, 6, 7 dhe 8 kate mbitokë, me 1 kat parkim nëntokë”, Zona 02, Zona e menaxhimit A02 dhe A04, me vendndodhje në “Marina & Jahtet e Durrësit”, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Durrës Marina” sh.a, mbetet e pandryshuar.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 23/12/ 2025